

# Ne besojmë në rezultatet tona!

## Interesohuni për cilësinë e shërbimeve tek klientët tanë:

Partnerët Shqipëri ka trajnuar, mbështetur dhe asistuar mbi 1500 drejtorë ekzekutivë, menaxherë, specialistë të lartë dhe punonjës të rinj të disa kompanive private dhe institucioneve financiare në Shqipëri si:

**Albanian Mobile Communications (AMC), Albanian Satellite Communication (TRING), Alpha Bank Albania, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Credins Bank; Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k, Eagle Mobile, First Investment Bank, International Commercial Bank, Opportunity Albania, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank Albania, Societe Generale Albania, Union Bank, etj.**

## Shprehni interesin tuaj!

Nëse jeni të interesuar për shërbimet tona dhe ju nevojitet më tepër informacion rreth përmbajtjes së trajnimeve, shërbimeve të konsulcencës dhe tarifave të shërbimit, na kontaktoni në:



**Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**  
Ruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12,  
Njësia Bashkiake 5, Kodi Postar 1022, Tiranë



**Kutia Postare (PO Box) 2418/1**



**Tel. 00355 4 2254881**



**Cel: 00355 697889600**



**www.partnersalbania.org**



**partners@partnersalbania.org**



© Modeli Denison. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

## Trajnim dhe Konsulcencë për Sektorin Privat

LEHTËSOJMË  
UDHËTIMIN  
TUAJ DREJT  
ZHVILLIMIT  
PROFESIONAL



[www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

# Zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore

## Trajnim dhe konsulencë

### Kush jemi?

Partnerët Shqipëri është themeluar si një organizatë e pavarur shqiptare, anëtare e Partners Global, një rrjet i 19 organizatave të pavarura në Evropë, Amerikën Veriore dhe Jugore, Afrikë dhe Lindjen e Mesme të cilat punojnë për një ndryshim paqësor e demokratik. Rrjeti ofron programe trajnimi, asistencë teknike dhe konsulencë për organizatat e shoqërisë civile, qeverinë, qendrore dhe vendore dhe sektorin privat në vendet e tyre dhe në mbarë botën.

### Çfarë ofrojmë dhe cilët janë përfituesit tanë

Zhvillimi i një sektori privat të fortë, dinamik dhe konkurrues në Shqipëri në vitet e fundit ka treguar nevojën për të rritur dhe zhvilluar më tej kapacitetet e burimeve njerëzore në nivele të ndryshme. Partnerët Shqipëri përdor trajnimin dhe konsulencën si mjete efektive për avancimin e njohurive dhe aftësive të burimeve njerëzore për të kontribuar në performancën dhe produktivitetin e kompanive.

**PSH asiston përmes kurseve të trajnimit, praktikave të lehtësimit të proceseve dhe mbështetjes, udhëheqjes e këshillimit:**

### Punonjësit e rinj dhe specialistët e lartë

- të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale.
- të reagojnë më mirë ndaj metodave alternative të të nxënës.
- të fokusohen në mundësitë për karrierë - ndryshim apo zhvillim karriere.
- të ri-integrohen në karrierë pas një periudhe shkëputjeje.

### Drejtuesit ekzekutivë dhe menaxherët

- të zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë ekzistuese dhe të reja drejtimi dhe menaxhimi.
- të zhvillojnë aftësi udhëheqëse dhe mbështetëse.
- të gjejnë zgjidhje për çështje sfiduese që ndikojnë në zhvillimin e mundësive për karrierë.

### Ekspertiza

#### Përse ne?

- Ne vlerësojmë nevojat tuaja dhe ju mbështesim përmes kurseve profesionale të përshtatura.
- Ne ofrojmë prezantime inovative dhe interesante, ndërvepruese dhe me pjesëmarrje.
- Ne ofrojmë ekspertë të kualifikuar me eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare në hartim, ofrim dhe vlerësim programesh trajnimi.
- Ne ofrojmë shërbime në dy gjuhë - shqip dhe anglisht.
- Ne krijojmë një mjedis të hapur dhe miqësor për të mësuar dhe zhvilluar njohuri dhe aftësi.



## Planifikoni me ne! Përqasja jonë



### HAPI 1

#### Vlerësojmë dhe analizojmë nevojat

#### Ne investohemi për të kuptuar nevojat e kompanisë

Para fillimit të çdo programi, ne diskutojmë dhe biem dakord mbi nevojat dhe pritshmëritë specifike të kompanisë duke respektuar të drejtën e konfidencialitetit.

**1** Vlerësojmë pritshmëritë duke u takuar me drejtuesit e Burimeve Njerëzore dhe menaxherët respektivë për të kuptuar më mirë nevojën për trajnim dhe asistencë teknike.

**2** Mbledhim informacionin e nevojshëm mbi nevojat përmes vëzhgimeve direkte, pyetësorëve dhe fokus grupeve.

**3** Përgatisim dhe ndajmë raportin e vlerësimit me kontraktorët.

**4** Inkorporojmë në program nevojat e identifikuara.

### HAPI 2

#### Diskutojmë dhe biem dakord mbi metodologjinë, strukturën dhe logjistikën

Partnerët Shqipëri është fleksibël në ofrimin e shërbimit të saj sipas nevojave dhe mundësive të klientëve.

- Metodat përzgjidhen me kujdes për të përputhur qëllimin me rezultatin e të nxënës.
- Ne ofrojmë shërbime gjatë ditëve të javës dhe në fundjavë.
- Çështjet logjistike përcaktohen në bashkëpunim me klientët.
- Grupet efektive nuk e kalojnë numrin nga 12-15 pjesëmarrës.

### HAPI 3

#### Ofrojmë Trajnime

#### Zgjidhje të përshtatura të të mësuarit

Trajnimi është një nga teknikat që Partnerët Shqipëri përdor për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të sektorit privat. Përmes kurrikulës së mëposhtme, PSH adreson nevojën për njohuri dhe përgatit individët për kompetencat e duhura të nevojshme për vendin e punës.

#### Aftësi të zhvillimit organizativ

- Menaxhimi i ndryshimit organizativ
- Menaxhimi i burimeve njerëzore
- Drejtimi dhe menaxhimi
- Supervizimi i punës
- Vendosja e objektivave dhe menaxhimi i vlerësimit të performancës
- Ndërtimi i ekupeve efektive dhe puna në ekip
- Planifikimi i punës, kohës dhe detyrave
- Menaxhimi i presionit dhe stresit në punë
- Menaxhimi i ciklit të projektit

#### Aftësi trainuese dhe prezantuese

- Metodat e vlerësimit të nevojave dhe raportimi
- Trajnim për trajnerë
- Aftësi prezantuese dhe të së folurës në publik

#### Aftësi të zhvillimit të forcës shitëse dhe marketingu

- Kujdesi ndaj klientit dhe teknika të komunikimit efektive
- Menaxhimi i ankesave të klientit dhe cilësia e shërbimit
- Procesi dhe teknikat e shitjes
- Negocimi në biznes
- Marrëdhëniet me publikun dhe marketingu

### HAPI 4

#### Vlerësojmë dhe raportojmë mbi trajnimin

Feedback-u juaj i vlefshëm na lejon të vlerësojmë impaktin e trajnimit, adaptojmë programet e ardhshme dhe t'ju ofrojmë një raport analitik mbi shërbimin e ofruar.

### HAPI 5

#### Ofrojmë konsulencë - praktika përtej trajnimit

#### Planifikojmë vazhdimësinë - lehtësim procesesh, udhëheqje dhe mbështetje

Partnerët Shqipëri zhvillon dhe ofron konsulencë teknike për klientët e interesuar duke mbështetur zhvillimin e proceseve të brendshme nëpërmjet lehtësimit të zbatimit në praktikë të rregulloreve, strategjive dhe taktikave të prezantuara gjatë kurseve të trajnimit.

#### Së bashku do të:

